

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga “Eternals” te miqësia e ngushtë... Angelina Jolie dhe Salma Hayek zbulojnë si u afruan kaq shumë! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/nga-eternals-te-miqesia-e-ngushte-angelina-jolie-dhe-salma-hayek-zbulojne-si-u-afruan-kaq-shume/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 08:31:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 08:26:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c41d0818faa30993e93b1e7f227f626bfa14f46c0f63b05c284ddad08320b5fc
TEKSTI	eeeaf43a951e3b367469c2a4957944a43facad2df321f90e1d2b4e8ca560a890
PAMJA	d322f46d5138bb20f795e50f394e2e30a9da5baa927f0cbaf985970159392349

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	88fdef133cbd7b66ea1e21ebee23668970d465011ba94b2b666486c1acbd75bf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7843691d73f82da58f46c5c712d0bec6679deb0584938ea073db401557569169
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/88fdef133cbd7b66ea1e21ebee23668970d465011ba94b2b666486c1acbd75bf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Celebrities Gossip Showbiz

Nga “Eternals” te miqësia e ngushtë... Angelina Jolie dhe Salma Hayek zbulojnë si u afruan kaq shumë!



Redaksia K

20 Shtator 2026



Angelina Jolie dhe Salma Hayek kanë treguar më shumë për miqësinë e tyre të veçantë, e cila nisi në xhirimet e “Eternals” dhe u forcua edhe më shumë gjatë realizimit të filmit “Without Blood”.



Dy aktoret u takuan rreth shtatë vite më parë, kur po promovonin filmin e Marvel, “Eternals”. Edhe pse ishte projekti i parë i tyre i përbashkët, lidhja mes tyre u krijua shumë shpejt dhe në mënyrë krejt natyrale.



Hayek ka treguar se që në fillim e ndjeu Jolie-n si një person me të cilin mund të ishte vetvetja. Sipas saj, marrëdhënia e tyre nuk u ndërtua mbi formalitete, por mbi një mirëkuptim të menjehershëm.

“E dua mënyrën si mendon dhe të kuptoj. Kur e di që dikush të kupton, ndihesh e sigurt dhe mund të jesh kushdo që je, në çdo rrethanë

-tha Hayek.



Por ishte puna në “Without Blood” ajo që e çoi miqësinë e tyre në një tjetër nivel. Këtë herë, **Jolie** ishte në rolin e regjisores, ndërsa Hayek interpreton personazhin kryesor, Nina, në filmin e bazuar në romanin e Alessandro Baricco-s.

Xhirimet ishin emocionalisht intensive, pasi historia trajton luftën, traumën, humbjen, kujtesën dhe faljen. Kjo bëri që bisedat mes dy grave të mos kufizoheshin vetëm te filmi.





Hayek tregoi se gjatë xhirimeve ato mund të diskutonin me shumë pasion, të qanin, të përqafoheshin dhe pak më vonë të shpërthenin në të qeshura.

“ Ndonjëherë fillonim të bërtisnim me pasion me njëra-tjetrën. Pastaj unë filloja të qaja, ajo më përqafonte dhe më pas qeshnim pa pushim

-rrëfeu aktorja.




Jolie e përshkroi këtë marrëdhënie si diçka që nuk e kishte përjetuar më parë në të njëjtën mënyrë.

“ Për ta vlerësuar atë miqësi, atë lidhje dhe atë mirëkuptim... nuk kam pasur një lidhje të tillë në jetën time

-tha ajo.





Sipas Jolie-t, një nga gjërat që e bën miqësinë e tyre kaq të veçantë është se të dyja mund të jenë të drejtpërdrejta me njëra-tjetrën pa pasur frikë se do të keqkuptohen.



Unë mund të them çfarë të dua. Ajo nuk ofendohet kurrë, sepse vjen nga unë

-tregoi Jolie, duke shpjeguar se diskutimet e tyre shpesh kalonin nga puna te emocionet dhe më pas te humori.



Për Hayek, ky besim ishte veçanërisht i rëndësishëm gjatë realizimit të “Without Blood”, pasi roli ishte ndër më sfiduesit emocionalisht që ajo kishte marrë përsipër.

Aktorja ka treguar se në momente të caktuara mund ta telefononte Jolie-n edhe në mes të natës kur ndihej e shqetësuar për personazhin. Jolie, sipas saj, ishte gjithmonë aty për ta ndihmuar të kuptonte më mirë rolin dhe emocionet e tij.

Një tjetër moment që Hayek e ka veçuar ishte kur Jolie i tha se nuk e kishte zgjedhur për rolin vetëm për shkak të forcës së saj si aktore, por për aftësinë për të përcjellë shërimin.



Nuk të zgjodha për forcën tënde. Të zgjodha për aftësinë tënde për të shëruar

-i kishte thënë Jolie.

Dhe miqësia e tyre nuk mbeti vetëm në kuadër të kinemasë. Të dyja kanë folur edhe për jetën familjare dhe fëmijët e tyre, ndërsa Hayek ka treguar se një nga gjërat që e bëri ta vlerësonte edhe më shumë Jolie-n ishte mënyra se si ajo silllet si nënë.

Tashmë, pas “Eternals” dhe “Without Blood”, dy aktoret duket se kanë krijuar një lidhje që shkon shumë përtej një bashkëpunimi profesional. Për to, filmi i fundit nuk solli vetëm një projekt të rëndësishëm kinematografik, por edhe një miqësi që të dyja e përshkruajnë si të rrallë dhe shumë të rëndësishme në këtë fazë të jetës së tyre.



TOP ALBANIA RADIO

Angelina Jolie ehfazat brash Zahara-e nënë e hijë tërhanin gjithë vëmendjen në New



Salma Hayek efidon mechën në tanatin e bujt!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.